



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KOMISIONI QENDROR I ZGJEDHJEVE
KOMISIONERI SHTETËROR I ZGJEDHJEVE

Data: 7.3.2025

Nr: 247

Ora: 18:00

VENDIM

PËR

**SHQYRTIMIN ADMINISTRATIV TË VEPRIMTARIVE PUBLIKE TË ZYRËS VENDORE
TË ARSIMIT PARAUNIVERSITAR FINIQ-DROPULL, PËR PERIUDHËN 23 SHKURT-1
MARS 2025**

Sot, më datë 7.3.2025, unë, Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve, mora në shqyrtim çështjen administrative me

SUBJEKT: Zyra Vendore e Arsimit Parauniversitar Finiq-Dropull,

OBJEKT: Shqyrtimi administrativ i veprimtarive publike të Zyrës Vendore të Arsimit Parauniversitar Finiq-Dropull, për periudhën 23 shkurt- 1 mars 2025.

BAZA LIGJORE: Nenet 19 pika 1, shkronja “n”, 92, të ligjit nr. 10019, datë 29.12.2008, “Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar, si dhe vendimi nr. 9, datë 24.12.2020, i Komisionit Rregullator “Për rregullat e raportimit të veprimtarive me karakter publik të çdo institucioni publik, e me kapital shtetëror, agjencive, enteve shtetërore, kategoritë e veprimtarive të ndaluara, si dhe monitorimin e veprimtarisë, sjelljes dhe përdorimit të burimeve njerëzore, financiare dhe logjistike të administratës shtetërore para zgjedhjeve”, i ndryshuar.

Në përfundim të këtij shqyrtimi,

KONSTATOJ:

Gjatë periudhës 23 shkurt -1 mars 2025, Zyra Vendore e Arsimit Parauniversitar Finiq-Dropull ka raportuar në ndërfaqen e raportimeve (NRI), 1 (një) veprimtari përtej afatit ligjor të përcaktuar në nenin 92, pika 2 të Kodit Zgjedhor, si vijon:

- “Prezantimi i drejtorit të ri ZVAP-Finiq-Dropull Zj. Arta Lasko. Drejtuesi i ri u prezantua nga Drejtori i DRAP Fier Zj. Zaira Gjika”, raportuar në datë 27.2.2025 për t’u zhvilluar në datë 27.2.2025.

Data: 7.3.2025 Nr. 247
Ora:18:00



“Për shqyrtimin administrativ të veprimtarive publike të Zyrës Vendore të Arsimit Parauniversitar Finiq-Dropull, për periudhën 23 shkurt -1 mars 2025”

Nëpërmjet postës elektronike, administrata e KQZ-së i ka kërkuar Zyrës Vendore të Arsimit Parauniversitar Finiq-Dropull një informacion sqarues në lidhje me shkaqet dhe rrethanat e kryerjes së shkeljes.

Pas njoftimit të kryer, personi përgjegjës për raportimin e veprimtarive publike të Zyrës Vendore të Arsimit Parauniversitar Finiq-Dropull ka dërguar pretendimet, duke sqaruar se: *“Raportimi është bërë më datë 27.02.2025 për një mbledhje prezantuese të titullarit të ri të ZVAP-së Finiq - Dropull. Kjo mbledhje nuk ishte e planifikuar më parë dhe u zhvillua në këtë datë, pra në datën 27.02.2025, pas marrjes në dijeni të e-mail zyrtar të ardhur nga Agjencia Kombëtare e Arsimit Parauniversitar, po në këtë ditë, data 27.02.2025 ora 08:31 AM. Informacioni i raportuar tek ju është bërë për të qenë korrekt dhe transparent. Ju informojmë se nuk ishte veprimtari e planifikuar por një mbledhje prezantuese ku titullari i DRAP Fier prezantoi titullarin e ri të ZVAP Finiq - Dropull (sipas e-mail zyrtar të datës 27.02.2025 mbledhja e prezantimit u zhvillua po në këtë datë dhe informacioni tek ju u dërgua po në këtë datë).*

Për sa më sipër, referuar të dhënave të aktivitetit të paraqitura në ndërfaqen e raportimeve si dhe pretendimeve të dhëna nga personi përgjegjës për raportim, konstatohet se veprimtaria e raportuar jashtë afatit nga Zyra Vendore e Arsimit Parauniversitar Finiq- Dropull nuk përbën veprimtari publike me detyrim për raportim. Në këto kushte, nuk jemi para rrethanave të një kundërvajtje administrative.

PËR KËTO ARSYE:

Bazuar në nenet 19, pika 1, shkronja “n”, të ligjit nr. 10019, datë 29.12.2008, “Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar, vendimin nr. 9, datë 24.12.2020, të Komisionit Rregullator “Për rregullat e raportimit të veprimtarive me karakter publik të çdo institucioni publik, e me kapital shtetëror, agjencive, enteve shtetërore, kategoritë e veprimtarive të ndaluara, si dhe monitorimin e veprimtarisë, sjelljes dhe përdorimit të burimeve njerëzore, financiare dhe logjistike të administratës shtetërore para zgjedhjeve”, i ndryshuar,

V E N D O S:

1. Pushimin e hetimit administrativ ndaj Zyrës Vendore të Arsimit Parauniversitar Finiq-Dropull.
2. Ky vendim do të njoftohet nëpërmjet postës elektronike.
3. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe publikohet në faqen zyrtare të internetit të Komisionit Qendror të Zgjedhjeve.
4. Kundër këtij vendimi mund të bëhet ankim në Komisionin e Ankimeve dhe Sanksioneve, brenda 3 (tre) ditëve nga shpallja e tij.

Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve

Ilirjan CELIBASHI